



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Dana

05 - 07 - 2018



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:005234

Datë: 31.05.2018

Numri i dokumentit: 00052361

P. nr. 273/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, sipas gjyqtarit Adem Shabani, dhe Zyrتaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaj, rruga “[REDACTED]”, nr. [REDACTED], për shkak të veprës penale detyrimi, nga nen 340 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1455-3/17 e dt.09.02.2018, pas mbajtjes së seancës fillestare publike me datë 31.05.2018, në prezencën e prokurorit të shtetit Albert Zejnallahu, të akuzuarit [REDACTED] dhe të dëmtuarit [REDACTED], mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

I akuzuari [REDACTED] nga Ferizaj, rruga “[REDACTED]”, nr. [REDACTED], i lindur më [REDACTED], në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e emri [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, punëtor fizik, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. Personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

- Me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete me datën 27 prill 2017, ka përdorur kanosje serioze për të detyruar personin tjeter të kryej ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij ashtu që, pasi është takuar me të dëmtuarin [REDACTED], me të cilin kishte lën një takim, përmes një personi me emrin [REDACTED], një shoku të përbashkt, hynë në veturen e tij lëvizin nëpër qytet, me të arritur në rrugën “[REDACTED]”, në Ferizaj,

fillimi shqiptar del nga automjeti, posa kthehet i merrë çelësat, pastaj godet me grusht në fytyrë dhe nxjerrë një thikë nga xhepi i majtë i jaknes, ku më pas ja merrë me dhunë veturën e tipit " Audi A4 ", me targa [REDACTED], dhe largohet,-

-me këte ka kryer vepren penale detyrimi, nga neni 340 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,23,41,43,46, 49, 50, 51 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së,e

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDACTED], i shqipton **DENIM ME GJOBË** në lartësi prej 300 (treqind) **Euro**, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 6/gjashtë/ muaj, me këste konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- dhe DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muaj, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimini me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Gjykata të dëmtuarin [REDACTED], me vendbanim në Gjilan, rruga " [REDACTED] ", nr [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk e ka udhëzuar në kontest civil pasi në shqyrtimin fillestar ka hequr dorë.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale- paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) **Euro**, dhe taksën në shumën prej 30 **Euro**, për Kompensimin e Viktimate të Krimtit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1455-3/17 e dt.09.02.2018, e ka ngarkuar të akuzuari [REDACTED], nga Ferizaj, rruga " [REDACTED]",nr. [REDACTED] për shkak të veprës penale detyrimi, nga nenii 340 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.31.05.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Albert Fejzullahu, i akuzuari [REDACTED] dhe i dëmtuari [REDACTED]

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim fillestar , ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës nga gjykata.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjtë e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtë i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUE], ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar , dhe është e vërtet se para këtij rasti nuk janë njohur me të dëmtuarin, por në bazë të një shokut të tij [REDAKTUE] janë takuar ditën kritike i kërkon falje të dëmtuarit është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe se vetura ju është kthyer të dëmtuarit, ka premtuar se veprime të tillë më nuk do të përsëris më, ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimt të mere për bazë theksimet e cekura tanë me të dëmtuarin nuk ka mosmarrëveshje, është martuar baba i dy fëmijëve, i pa punë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Albert Fejzullahu, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëtin ta pranoj si të tillë.

I dëmtuari [REDAKTUE] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale që akuzohet, por nuk parashtron kërkësë pasurore-juridike edhe pse ka marrë lëndime personale dhe shkaktuar dëme material në veturën e tij të cilën me dhunë i kishte marrë por më vonë nga ana e policisë i'u është kthyer dhe me të pandehurin nga ky rast më nuk është takuar me te dhe nuk parashtron kërkësë pasurore-juridike.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë në kallëzimin penale nr.2017-CF-889 i datës 03.08.2017, Vërtetimin mbi kthimin e sendeve i datës 26.04.2017 fotografit e automjetit “ Audi A4 ”,dhe provat tjera të cilat gjinden në lendë, deklaratën e të dëmtuarit ,dëshmitarit.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazduar me shqiptimin e dënimt kundër të akuzuarit për veprën penale që akuzohet.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale detyrimi, nga nenit 340 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, në shqyrtimin fillestar të dëmtuarit i kërkon falje për veprën penale, është penduar, premtimin se në të ardhmen më nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme, i dëmtuarit [REDACTED] nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike pasi vetura iu është kthyer, pastaj gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmérinë konkrete të veprës penale, duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmérinë konkrete të veprës penale, të akuzuarit i vërtetoi dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata mbështetur në nenit 461 par.1 të KPPK-së, të dëmtuarin [REDACTED], me vendbanim në Gjilan, rruga " [REDACTED]", nr. [REDACTED], pasi në shqyrtimin fillestar ka hequr dorë nga kërkesa pasurore - juridike, nuk e ka udhëzuar në kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimateve të krimtit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.273/18 me datë 31.05.2018

Zyrtari Ligjor
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.